



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 11.12.2024

Nr: 209

Ora: 15:00

**VENDIM**

**PËR**

**MIRATIMIN E RAPORTIT MBI GJETJET PAS VLERËSIMIT TË REGJISTRIMEVE  
FILMIKE GJATË IMPLEMENTIMIT TË VOTIMIT ELEKTRONIK NË BASHKITË  
KAMËZ, VORË DHE ELBASAN, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES  
VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronjat “c” e “n”, e 2, nenit 22, pika 8, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**V E N D O S:**

1. Miratimin e gjetjeve të raportit mbi vlerësimin e veprimtarisë së operatorëve të PEVN, për bashkitë Kamëz, Vorë dhe Elbasan, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas materialit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. T’i kërkoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve vendosjen e sanksioneve administrative ndaj Operatorëve të Pajisjeve Elektronike të Votimit dhe Numërimit (PEVN) përgjegjës për shkeljet e konstatuara nga këqyrja, sipas listës në aneksin nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: 11.12.2024 Nr: 209  
Ora: 15:00



“Për miratimin e raportit mbi gjetjet pas vlerësimin të regjistrimeve filmike gjatë implementimit të votimit elektronik në bashkitë Kamëz, Vorë dhe Elbasan, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”

**RAPORT**  
**MBI IMPLEMENTIMIN E VOTIMIT ELEKTRONIK NË BASHKITË**  
**KAMËZ, VORË DHE ELBASAN, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E**  
**QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

---

Përmbajtja	
I. Hyrje.....	2
II. Proçesi Përgatitor i Votimit Elektronik (VE).....	2
1. Përmirësime teknike të sistemit të VE .....	2
2. Konfigurimi i fletës së votimit dhe raporteve .....	3
3. Trajnimi i Operatorëve.....	3
4. Edukimi dhe informimi i zgjedhësve .....	4
5. Testimi i Pajisjeve .....	5
III. Dita e zgjedhjeve .....	5
IV. Problematika të identifikuara .....	6
1. Problematika të përgjithshme: .....	6
2. Problematika të veprimit të operatorëve .....	7
V. Rekomandime për Përmirësim .....	8

Data: 11.12.2024 Nr: 209  
Ora: 15:00



“Për miratimin e raportit mbi gjetjet pas vlerësimit të regjistrimeve filmike gjatë implementimit të votimit elektronik në bashkitë Kamëz, Vorë dhe Elbasan, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”

## I. Hyrje

Neni 22, pika 1, e Kodit Zgjedhor, i jep Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) kompetencën për të eksperimentuar dhe vendosur mbi përdorimin e sistemeve dhe pajisjeve teknologjike në proceset zgjedhore. Ky nen përcakton që përdorimi i teknologjisë duhet të realizohet përmes projekteve pilot, duke mbuluar të paktën 10% të numrit të përgjithshëm të zgjedhësve për çdo fazë të implementimit.

Komisioni Rregullator me vendim nr. 04, datë 13.11.2020, “Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e votimit dhe numërimit elektronik që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përcaktoi karakteristikat dhe standardet teknike të pajisjeve të elektronike votimit dhe të numërimit (PEVN) që do të përdoren në proceset zgjedhore vijuese. – (shiko Aneksin I për karakteristikat teknike të PEVN)

Me vendim nr. 16, datë 13.4.2023, “Për përdorimin e pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”, të Komisionit Rregullator, u vendos që për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore 14 maj 2023, PEVN të përdorej në bashkitë Kamëz, Vorë dhe Elbasan.

Këto tre bashki kanë gjithsej 401 qendra votimi (QV), me 347,561 votues të regjistruar.

## II. Procesi Përgatitor i Votimit Elektronik (VE)

### 1. Përmirësime teknike të sistemit të VE

Në kuadër të përgatitjeve për zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023, u kryen disa personalizime dhe përmirësime teknike në softuerin e votimit elektronik, duke synuar përmirësimin e funksionalitetit dhe sigurisë së procesit, si të tilla:

- a. Integrimi me Printerin e Ri “Cut and Drop” (CDE-110): Integrimi me printerin e ri “Cut and Drop”, i cili mundësonte si printimet e VVPAT ( Voter Verified Paper Audit Trail ), ashtu edhe printimin e raporteve për administratën zgjedhore (raporte të hapjes dhe mbylljes).
- b. Transmetimi i Rezultateve nga Vendi i Votimit: Transmetimi i rezultateve nga vendi i votimit u realizua përmes një modemi USB 3G/4G për dërgimin e të dhënave, i cili u vendos në pajisje pas mbylljes së votimit dhe printimit të rezultatit brenda kutisë së votimit.

Data: 11.12.2024 Nr: 209  
Ora: 15:00



“Për miratimin e raportit mbi gjetjet pas vlerësimit të regjistrimeve filmike gjatë implementimit të votimit elektronik në bashkitë Kamëz, Vorë dhe Elbasan, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”

- c. Përmirësime në Panelin e Kontrollit: Përmirësimet në panelin e kontrollit dhe menunë e administrimit të zgjedhjeve përfshijnë diagnostikimin për pajisjet e reja dhe shtimin e logos së Komisionit në fund të ekranit.
- d. VVPAT (Voter Verified Paper Audit Trail - Gjurmë Letre e Verifikuar nga Votuesi për Auditim): Printimi i një VVPAT për çdo proces votimi, një për votimin për kryetar bashkie dhe një për votimin për keshillin bashkiak, si dhe heqja nga kodi QR të të dhënave që mund të lidhin dy kuponët, nga e njëjta seancë votimi.
- e. Procedura e Mbylljes së Votimeve: Procedura e mbylljes së votimeve përfshin printimin e një raporti rezultatesh me kod QR drejt kutisë të votimit, si dhe mundësinë për të printuar 8 kopje të raporteve përfundimtare pa detaje dhe 8 kopje të raporteve të rezultateve me kod QR.

Këto personalizime kanë përmirësuar funksionalitetin dhe përputhshmërinë e PEVN-së me votimin tradicional, duke lehtësuar procesin e përgatitjes, si dhe eksperiencën zgjedhore të votuesve.

## 2. Konfigurimi i fletës së votimit dhe raporteve

Në PEVN u konfiguruan dy fletët e votimit, ajo për kryetarin e bashkisë dhe ajo për keshillin bashkiak, për të tre bashkitë.

Për të ndihmuar zgjedhësit gjatë procesit të votimit nëpërmjet PEVN, konfigurimi i këtyre fletëve ishte i ngjashëm me atë të fletëve të votimit letër.

Po ashtu u përshtatën edhe raportet që gjenerohen nga PEVN si raporti i hapjes së votimit, konfirmimin e fletës së votimit ( VVPAT), raporti i mbylljes si dhe rezultati .– (shiko *Aneksin 2 për përmbajtjen e fletëve të votimit dhe të raporteve të printuara gjatë procesit zgjedhor*)

## 3. Trajnimi i operatorëve

KQZ zhvilloi një proces të organizuar për të trajnuar operatorët e PEVN, duke synuar një zbatim të suksesshëm të teknologjisë gjatë zgjedhjeve. Si hap i parë, u realizua trajnim i dedikuar për trajnerët (ToT), ku 25 trajnerë u përgatitën me udhëzime të detajuara për të transmetuar njohuritë e tyre tek operatorët e PEVN. Ky trajnim u zhvillua në shkollën "Kosova" në Tiranë, me mbështetjen e kompanisë që ofron suportin për VE. Në këtë fazë u përfshinë edhe trajnerët e KZAZ-ve ku do të implementohej VE, duke mundësuar shkëmbimin e informacionit mbi funksionimin e pajisjeve me anëtarët e ZAZ-ve.

Përgatitja e teknikëve të mbështetjes në terren u realizua më 6 maj 2023, po ashtu në shkollën "Kosova". Të 61 pjesëmarrësit e parashikuar morën pjesë dhe përfunduan me sukses trajnimin. Trajnimi kishte si synim pajisjen e tyre me aftësitë e nevojshme për të zgjidhur problemet teknike gjatë procesit të votimit.

Trajnimi i operatorëve u organizua në periudhën 30 prill – 7 maj 2023 në Tiranë dhe Elbasan, sipas një kalendari të përcaktuar, duke përfshirë gjithsej 423 operatorë, të ndarë në grupe prej 20 vetësh. Për operatorët që nuk mundën të marrin pjesë në seancat e planifikuara, u organizuan trajnime shtesë. Kurrikula e trajnimit përfshinte një kombinim të njohurive teorike mbi funksionimin e pajisjeve dhe ushtrimeve praktike për përdorimin e tyre. Përmes simulimeve, operatorët u trajnuan të identifikojnë dhe zgjidhin problemet që mund të lindnin gjatë procesit të votimit, si dhe të ofrojnë asistencë në rastet e nevojshme.

Ky proces gjithëpërfshirës synonte që trajnerët, teknikët dhe operatorët të ishin të përgatitur plotësisht për të kontribuar në një proces zgjedhor të suksesshëm dhe të mbështetur nga teknologjia.

#### 4. Edukimi dhe informimi i zgjedhësve

Për të informuar dhe edukuar qytetarët mbi përdorimin e PEVN, u zhvillua një fushatë informuese që përfshinte shpërndarjen e mbi 25,000 broshurave dhe organizimin e më shumë se 300 seancave demonstrimi në vende publike për t'i familjarizuar qytetarët me procesin. Fushata kishte për qëllim ndërgjegjësimin e zgjedhësve mbi votimin dhe numërimin elektronik dhe u realizua përmes disa kanaleve kryesore. Spote televizive<sup>1</sup> informuese u transmetuan nga data 5 deri më 14 maj 2023, me gjithsej 300 transmetime. Në të njëjtën periudhë, 550 postera u vendosën në qendrat e votimit të bashkive Elbasan, Vorë dhe Kamëz, duke prezantuar hapat e votimit elektronik. Mesazhe informuese u shfaqën edhe përmes LedWall në Elbasan dhe Kamëz, nga 27 prilli deri më 14 maj 2023, me një total prej 1790 transmetimesh.

Në rrjetet sociale, përfshirë Facebook, Instagram, Twitter dhe YouTube, u publikuan materiale ndërgjegjësuese që nga 27 prilli deri më 14 maj 2023. Postera informues me përmasa të mëdha u vendosën edhe në 4 stacione autobusi, ndërsa 5 billboard me përmbajtje të ngjashme u instaluan në Vorë dhe Kamëz gjatë të njëjtës periudhë.

Për të njohur qytetarët me procesin dhe sigurinë e pajisjeve, demonstrime publike<sup>2</sup> u zhvilluan nga 18 prilli në bashkitë Elbasan, Vorë dhe Kamëz, duke përfshirë lokacione si Teatri “Skampa” në Elbasan dhe shkolla “Isa Boletini” në Kamëz. Fushata e demonstrimit të pajisjeve PEVN u zhvillua gjatë një periudhe 7-ditore, duke shërbyer si një mjet edukimi për zgjedhësit, me qëllim familjarizimin e tyre me procesin dhe përdorimin e teknologjisë së votimit elektronik.

<sup>1</sup> [Shiko spotet.](#)

<sup>2</sup> [Shiko demonstrimin.](#)



Në këtë proces u përdorën gjithsej 14 pajisje PEVN, të shpërndara në bazë të shtrirjes dhe madhësisë së bashkive: 6 pajisje për bashkinë Elbasan, 4 për bashkinë Kamëz dhe 2 për bashkinë Vorë. Për të siguruar mbështetje në raste emergjente, 2 pajisje u mbajtën në rezervë.

### 5. Testimi i pajisjeve

Më 4 maj 2023, u realizua Testimi Publik Operacional i PEVN, i njohur gjithashtu si Testimi i Pranimit nga Përdoruesit (User Acceptance Testing - UAT). Ky testim kishte për qëllim të verifikonte funksionalitetin dhe besueshmërinë e sistemit në kushte reale, përpara se ai të përdorej në zgjedhje. Në testim morën pjesë përfaqësues të partive politike, medias, organizatave vendase dhe ndërkombëtare. Aktiviteti u organizua nga KQZ në një ambient të paracaktuar.

Për testimin operacional u përdorën 24 pajisje PEVN, që përfaqësonin 3% të totalit të pajisjeve që u përdorën në zgjedhjet elektronike në bashkitë Elbasan, Kamëz dhe Vorë. Pajisjet u shpërndanë sipas zonave përkatëse:

- 13 pajisje për bashkinë Elbasan,
- 8 pajisje për bashkinë Kamëz,
- 3 pajisje për bashkinë Vorë.

Gjatë testimit operacional, u ekzekutuan një sërë procesesh për të verifikuar funksionalitetin e pajisjeve elektronike. Proceset përfshinin hapjen e votimit, simulimin e votimit me 50 vota në çdo pajisje, dhe mbylljen e votimit. Pas përfundimit të votimit, u printuan raportet individuale nga pajisjet PEI, rezultatet u transmetuan elektronikisht dhe u gjeneruan raporte përmbledhëse për çdo ZAZ nga sistemi.

Testimi publik operacional konfirmoi që pajisjet dhe sistemi funksiononin siç duhet dhe ishin të gatshme për t'u përdorur në zgjedhjet reale. Procesi ndihmon në rritjen e besimit të qytetarëve dhe aktorëve të përfshirë, në sistemin elektronik të votimit.

## III. Dita e zgjedhjeve

### 1. Pjesëmarrja dhe ecuria

Bashkitë Elbasan, Kamzë dhe Vorë kanë 401 qendra votimi (QV), me 347,561 votues të regjistruar. Pjesëmarrja në votime ishte 47.8%, që përfaqësonte 166,180 zgjedhës që votuan. Disa votues hasën vështirësi për shkak të mungesës së informacionit mbi procedurën.

Data: 11.12.2024 Nr: 209  
Ora: 15:00



“Për miratimin e raportit mbi gjetjet pas vlerësimit të regjistrimeve filmike gjatë implementimit të votimit elektronik në bashkitë Kamëz, Vorë dhe Elbasan, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”

Qendra Kombëtare e Mbështetjes (Helpdesk), funksionale në datat 13 dhe 14 maj luajti një rol të rëndësishëm në sigurimin e një procesi të qëndrueshëm dhe të qetë. Ajo ofroi mbështetje për çdo problem që mund të lindte gjatë instalimit të pajisjeve, duke përfshirë trajtimin e çështjeve logjistike, operative dhe teknike në terren.

12 agjentët mbështetës dhe 6 shpërndarës ishin të pranishëm për të trajtuar çdo problem të raportuar nga operatorët në vendet e votimit. Gjatë ditës, janë hapur 57 bileta për të trajtuar këto probleme, dhe të gjitha biletat u mbyllën dhe u zgjidhën me sukses, duke treguar një menaxhim të mirë të situatave që u paraqitën.

Në një rast, një pajisje PEVN u zëvendësua, që përfaqëson një përqindje shumë të ulët dështimi prej 0.12% në krahasim me 802 PEVN-të e instaluar në terren. Ky rezultat tregon një realizim të suksesshëm të instalimit të PEVN-ve.

## 2. Përfundimi i votimit. Numërimi dhe vlerësimi i votave.

Pajisjet elektronike regjistruan të gjitha votat me saktësi të plotë, ndërsa procesi i numërimit përfundoi brenda 3 orësh pas mbylljes së qendrave të votimit. Në orën 7 të mbrëmjes të datës 14 maj, filloi transmetimi i rezultateve nga vendet e votimit. Stafi i Qendrës Kombëtare të Mbështetjes mbështeti dhe udhëzoi operatorët e PEVN-ve se si të lidhin modemët dhe të realizojnë transmetimin. Në zonat e pambuluara me vale nga operatori ISP, për të kryer tabulimin e rezultatit paraprak u përdorën rezultatet e gjeneruara nga pajisja dhe të transmetuara nga operatorët. Rezultati përfundimtar u konfirmua nga mbledhja dhe kalimi i informacionit në ZAZ.

Ky rezultat përfaqëson një përmirësim të jashtëzakonshëm krahasuar me proceset manuale të mëparshme, të cilat kërkonin mesatarisht 48 orë për përfundimin e numërimit.

## IV. Problematika të identifikuar

### 1. Problematika të përgjithshme:

Implementimi i VE në bashkitë e përzgjedhura evidentoi disa problematika të listuar në vijim:

- Vështirësi të zgjedhësve në përdorimin e teknologjisë. Një pjesë e votuesve sidomos në zonat rurale hasën vështirësi në përdorimin e pajisjeve elektronike PEVN, për shkak të mungesës së njohurive mbi teknologjinë e re dhe procedurat e votimit elektronik.
- Trajnimi i operatorëve. Disa operatorë devijuan nga udhëzimet e marra gjatë trajnimit, duke asistuar apo ndihmuar votuesit përtej mënyrës së udhëzuar dhe trajnuar nga KQZ.

- c. Shpërndarja e pajisjeve PEVN. Me rritjen e numrit të bashkive dhe qarqeve ku planifikohet të implementohet votimi elektronik, procedurat aktuale për shpërndarjen e pajisjeve në qendrat e votimit janë të vështira dhe joefikase.

## 2. Problematika të veprimit të operatorëve

KQZ në vlerësim të pretendimeve për veprimet e operatorëve të caktuar në ditën e votimit, bëri një shqyrtim të pamjeve filmike të përfituara nga kamerat e monitorimit në qendrat e votimit të të tre bashkive.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së këtyre kamerave rezultoi se disa prej tyre nuk ofronin pamje të qartë për të nxjerrë konkluzione mbi mënyrën e përmbushjes së përgjegjësisve nga operatorët e PEVN.

Gjithsesi nga përmbajtja e atyre kamerave që kishin pamje filmike të qarta u evidentuan disa shkelje të procedurave nga ana e operatoreve si më poshtë:

Në Bashkinë Vorë u evidentuan 3 raste të dokumentuara, si me poshtë:

- Operatori në QV nr. 1546/00 asiston/ndihmon votuesit, përtej mënyrës së udhëzuar dhe trajnuar nga KQZ;
- Operatori në QV nr. 1549/00 asiston/ndihmon votuesit përtej mënyrës së udhëzuar dhe trajnuar nga KQZ;
- Operatori në QV nr. 1563/00 asiston/ndihmon votuesit përtej mënyrës së udhëzuar dhe trajnuar nga KQZ.

Në Bashkinë Elbasan u evidentuan 12 raste të dokumentuara, si me poshtë:

- Operatori në QV nr. 2449/00 asiston/ndihmon votuesit përtej mënyrës së udhëzuar dhe trajnuar nga KQZ;
- Operatori në QV nr. 2343/00 asiston/ndihmon votuesit përtej mënyrës së udhëzuar dhe trajnuar nga KQZ;
- Operatori në QV nr. 2379/00 asiston/ndihmon votuesit përtej mënyrës së udhëzuar dhe trajnuar nga KQZ;
- Operatori në QV nr. 2381/00 asiston/ndihmon votuesit përtej mënyrës së udhëzuar dhe trajnuar nga KQZ;
- Operatori në QV nr. 2383/00 asiston/ndihmon votuesit përtej mënyrës së udhëzuar dhe trajnuar nga KQZ;
- Operatori në QV nr. 2383/01 asiston/ndihmon votuesit përtej mënyrës së udhëzuar dhe trajnuar nga KQZ;



- Operatori në QV nr. 2390/00 asiston/ndihmon votuesit përtej mënyrës së udhëzuar dhe trajnuar nga KQZ;
- Operatori në QV nr. 2407/00 asiston/ndihmon votuesit përtej mënyrës së udhëzuar dhe trajnuar nga KQZ;
- Operatori në QV nr. 2421/00 asiston/ndihmon votuesit përtej mënyrës së udhëzuar dhe trajnuar nga KQZ;
- Operatori në QV nr. 2433/00 asiston/ndihmon votuesit përtej mënyrës së udhëzuar dhe trajnuar nga KQZ;
- Operatori në QV nr. 2481/01 asiston/ndihmon votuesit përtej mënyrës së udhëzuar dhe trajnuar nga KQZ;
- Operatori në QV nr. 2432/00 asiston/ndihmon votuesit përtej mënyrës së udhëzuar dhe trajnuar nga KQZ.

Në Bashkinë Kamëz u evidentuan 2 raste të dokumentuara, si më poshtë:

- Operatori në QV nr. 1589/00 asiston/ndihmon votuesit përtej mënyrës së udhëzuar dhe trajnuar nga KQZ;
- Operatori në QV nr. 1600/00 asiston/ndihmon votuesit përtej mënyrës së udhëzuar dhe trajnuar nga KQZ.

Në total, 17 operatorë rezultuan në shkelje, duke përfaqësuar **2.1% të QV-ve, ku u përdor votimi elektronik.**

**Shënim:** Në Aneksin nr. 3 bashkëlidhur këtij raporti, do të gjeni tabelën e detajuar mbi KQV-të, ku janë evidentuar shkeljet nga operatorët PEVN, gjatë zgjedhjeve për qeverisjen vendore të datës 14 maj 2023

## V. Rekomandime për Përmirësim

Për të përmirësuar procesin zgjedhor dhe për të garantuar një nivel më të lartë transparence dhe efektiviteti, janë propozuar disa masa të rëndësishme që synojnë përmirësimin e disa aspekteve të organizimit dhe administrimit të zgjedhjeve

- Trajnimi i operatorëve duhet të thellohet, duke zgjeruar kohëzgjatjen e tij dhe duke vënë theksin te ruajtja e fshehtësisë së votës dhe menaxhimi i situatave të ndërlikuara. Kjo do të bëjë që operatorët të sigurojnë aftësi të plota për menaxhimin e pajisjeve dhe ruajtjen e integritetit të procesit.

- Në aspektin teknologjik, është e rëndësishme të zbatohet funksioni për anulimin e votës së printuar (VVPAT), për të dy fletët e votimit (kur është rasti i zgjedhjeve vendore).
- Një auditim i pavarur nga kompani të specializuara kombëtare/ndërkombëtare do të kontribuojë në rritjen e standardeve dhe besueshmërisë së procesit.
- Edukimi i votuesve mbetet një element kyç. Organizimi i fushatave masive për informimin mbi procesin elektronik të votimit dhe shpërndarja e materialeve instruktuese do të ndihmojnë që qytetarët të jenë plotësisht të informuar dhe të aftë për të kryer votimin pa pasur nevojë për ndihmë, duke reduktuar kështu varësinë nga operatorët dhe duke siguruar një proces më të pavarur dhe të drejtë.

Data: 11.12.2024 Nr: 209  
Ora: 15:00



“Për miratimin e raportit mbi gjetjet pas vlerësimit të regjistrimeve filmike gjatë implementimit të votimit elektronik në bashkitë Kamëz, Vorë dhe Elbasan, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”

## Aneks 1

### Karakteristikat teknike te PEVN<sup>1</sup>

1. *Procesi i votimit dhe numërimit elektronik të votave ku do të zbatohen projekte pilot, do të kryhet me anë të sistemit dhe/ose pajisjeve elektronike, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.*
2. Për votimin dhe numërimin elektronik do të implementohet Sistemi Elektronik i Menaxhimit të Votimit dhe Rezultateve (SEMVR), dhe do të përdoren Pajisje Elektronike të Votimit dhe Numërimit (PEVN).
3. Sistemi, nëpërmjet PEVN-ve, do të realizojë votimin elektronik, si dhe përlllogaritjen e saktë dhe të shpejtë të rezultatit, në nivel Qendre Votimi, pas mbylljes së procesit të votimit përkatësisht në secilën QV.
4. Procesi i votimit dhe numërimit elektronik duhet të bazohet/respektojë të njëjtat parime votimi dhe numërimi, sikurse kryhet në kushte manuale, si dhe të sigurojë qartësi dhe lehtësi përdorimi për votuesin.
5. SEMVR duhet t'i garantojë KQZ-së një mjet të sigurt për të konfiguruar, organizuar dhe mbikëqyrur procesin e votimit dhe numërimit elektronik.
6. SEMVR duhet të operojë në pajisje dhe në rrjet të dedikuar, e të paaksesueshëm, dhe të jetë e vendosur në mjediset e KQZ-së. SEMVR duhet të mundësojë konfigurimin e plotë të Pajisjeve Elektronike të Votimit dhe Numërimit (PEVN), si edhe qendërzimin e të dhënave në mënyrë të sigurt nga të gjitha PEVN.
7. SEMVR duhet të mundësojë konsolidimin dhe nxjerrjen e rezultatit pas mbylljes së votimeve dhe marrjes së rezultateve të qendrave të votimit nga çdo PEVN.
8. Pasi ka dalë rezultati, sipas pikës 7 të këtij vendimi, në QV ku është implementuar sistemi, ofruesi i implementimit të sistemit duhet të mundësojë integrimin e rezultatit të shpallur në qendrat ku janë përdorur PEVN me rezultatet e qendrave të votimit ku nuk janë përdorur PEVN.
9. Ofruesi i implementimit të sistemit dhe furnizimit të pajisjeve duhet të garantojë mirëmbajtjen e sistemit dhe furnizimit të pajisjeve (përfshirë zëvendësimin e PEVN brenda 2 orësh).
10. Implementimi i SEMVR duhet të sigurojë që:
  - a. Qendra e Votimit duhet të jetë e pajisur me të paktën dy PEVN.
  - b. Procesi i identifikimit dhe procesi i votimit dhe numërimit elektronik janë tërësisht të ndarë prej njëri tjetrit për të pamundësuar lidhjen e votuesit me votën. Gjithashtu nuk duhet të ketë komunikim apo shkëmbim të dhënash midis pajisjeve elektronike të identifikimit (PEI) dhe pajisjeve elektronike të votimit dhe numërimit (PEVN).

<sup>1</sup> Pjese e vendimit 4/2020 te Komisionit Rregullator “Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e votimit”, i ndryshuar

c. Sistemi duhet të garantojë plotësisht integritetin e të dhënave që ruhen në pajisje. Çdo votë në PEVN duhet të ruhet në dy memorie fizike të veçanta, por pjesë të pajisjes, pa referenca kohore dhe duhet të garantohet me standardet më të lartë të fshehtësisë. PEVN i garanton votuesit konfirmimin e votës nëpërmjet shfaqjes së saj në ekran. PEVN do të mundësojë versionin elektronik dhe versionin fizik të votës. Versioni fizik i votës do të printohet dhe do të bjerë në kutinë e montuar në pajisje.

d. Ekranin me prekje i PEVN duhet të ketë përmasa të mjaftueshme për t'u përdorur lehtësisht nga votuesi dhe të pamundësojë për aq sa është e mundur, fotografimin e votës.

e. PEVN duhet të garantojë prodhimin fizik të raporteve, sipas kërkesave të KOZ-së.

f. PEVN duhet të jetë një pajisje plotësisht e integruar, pa komponentë të jashtëm e cila mund transportohet dhe të vendoset në punë lehtësisht. PEVN duhet të pamundësojë çdo ndërhyrje të paautorizuar ndaj çdo komponenti të brendshëm ose porte komunikimi, duhet të jetë fizikisht e mbyllur dhe e siguruar me vula sigurie. Kutia e mban dokumentin e printuar sipas parashikimit të germës "c", të pikës 10, të këtij vendimi duhet të sigurojë integritetin fizik të saj nga ndërhyrje të paautorizuara. g. PEVN duhet të veprojë në mënyrë autonome dhe pa u lidhur në rrjetet e komunikimeve elektronike.

h. PEVN duhet të:

i. Aktivizohet për çdo votues nga ana e Komisionerit të QV-së.

ii. Mbyllet automatikisht pas votimit të çdo votuesi.

iii. Shfaqë qartë fletën e votimit sipas modelit të miratuar nga KQZ-ja.

iv. Mundësojë që zgjedhësi të votojë në përputhje me parashikimet e Kodit zgjedhor.

i. PEVN duhet të ketë bateri për të operuar përgjatë gjithë procesit të votimit dhe numërimit, të pavarur nga energjia elektrike.

j. Në rastet kur procesi i votimit ka më shumë se një votim (zgjedhje të përgjithshme, zgjedhje vendore, referendum etj.), votuesit do t'i jepet mundësia të votojë me radhë për secilin nga llojet e votimit.

k. Votuesit duhet t'i mundësohet verifikimi dhe konfirmimi i çdo zgjedhjeje të bërë, përfshirë dhe konfirmimin e verifikimit të versionit fizik të votës si dhe kutia të mundësojë për aq sa është e mundur, fotografimin e votës.

l. Votuesit dhe komisioni nuk duhet të kenë akses në pajisje dhe as në kutinë e ruajtjes së dokumenteve të PEVN.

m. Pas mbylljes të procesit të votimit, për qëllim të pasqyimit të rezultatit paraprak të çdo qendre votimi, PEVN, pasi printon procesverbalin e rezultatit të votimit, mundëson transmetimin e këtij rezultati me siguri maksimale dhe pa cenuar integritetin e informacionit drejt Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Votave dhe Rezultateve (SEMVR) në KQZ dhe jo

anasjelltas. Rregullat mbi llojin e të dhënave që transmetohen, raportet e printuara nga PEVN dhe administrimin e tyre miratohen me akt të Komisionit Rregullator.

11. KQZ-ja për të garantuar besueshmërinë dhe integritetin e procesit, verifikon sistemin sipas nenit 22, pika 7, të Kodit Zgjedhor.

Data: 11.12.2024 Nr: 209  
Ora: 15:00



“Për miratimin e raportit mbi gjetjet pas vlerësimit të regjistrimeve filmike gjatë implementimit të votimit elektronik në bashkitë Kamëz, Vorë dhe Elbasan, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”

## Aneks 2

### Pamje e fletëve të votimit dhe të raporteve të printuara nga PEVN

Shembuj të fletëve të votimit dhe raporteve të gjeneruara gjatë procesit zgjedhore. Fletët të votimit të konfiguruar në pajisjet PEVN për zgjedhjet vendore të 14 maj 2023 dhe krahasimi i tyre me fletën e votimit të përdorur për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie në 2022.

Fleta e votimit për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar Bashkie 2022	Fletë Votimi për Kryetar Bashkie 14 maj 2023	Fletë Votimi për Këshill Bashkiak 14 maj 2023																																																																																																																																																																					
<p>REPUBLICA E SHQIPËRISË KOMISIONI QENDOR I ZGJEDHJEVE <b>FLETË VOTIMI</b></p> <p>Qarku Tiranë Bashkia Vorë Zgjedhjet për Kryetarin e Bashkisë, 6 Mars 2022 ku Tiranë hkiia Vorë ZAZ Nr. 26 QV: 1551.1_01</p> <p>Zgjidh kandidatin</p> <p>1 <input type="checkbox"/> Kandidati 1 Partia/Koalicioni 1</p> <p>2 <input type="checkbox"/> Kandidati 2 Partia/Koalicioni 2</p> <p>3 <input type="checkbox"/> Kandidati 3 Partia/Koalicioni 3</p> <p><input type="checkbox"/> Nuk zgjedh asnjë kandidat</p> <p><input type="button" value="Printo votën"/></p>	<p><b>FLETË VOTIMI</b></p> <p>QARKU Bavarlo BASHKIA Mynih ZAZ Nr. 123 QVN: 123 Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore 14 maj 2023</p> <p>KANDIDATËT PËR KRYETAR BASHKIE <small>shprehim votuesit</small></p> <p>1 <input type="checkbox"/> EMËR ATËSIA MBIEMËR Partia e Bashkimit të Motoristëve P B M</p> <p>2 <input type="checkbox"/> EMËR ATËSIA MBIEMËR Koalicioni I PLF, PBB, GNC, PAT, RIN T T S</p> <p>3 <input type="checkbox"/> EMËR ATËSIA MBIEMËR Koalicioni I PLF, PBB, GNC, PAT, RIN K Z T</p> <p>4 <input type="checkbox"/> EMËR ATËSIA MBIEMËR Partia e Qëndrueshme P Q</p> <p>5 <input type="checkbox"/> EMËR ATËSIA MBIEMËR Kandidat i propozuar nga zgjedhësit</p>	<p><b>FLETË VOTIMI</b></p> <p>QARKU Bavarlo BASHKIA Mynih ZAZ Nr. 123 QVN: 123 Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore 14 maj 2023</p> <p>KANDIDATËT PËR KËSHILLIN BASHKIAK</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>1</th> <th>PARTIA E BASHKIMIT TË MOTORISTËVE</th> <th>EMËR MBIEMËR</th> <th>P B M</th> <th>1</th> </tr> </thead> <tbody> <tr><td>2</td><td>PARTIA E QËNDRUESHME</td><td>EMËR MBIEMËR</td><td>P Q</td><td>2</td></tr> <tr><td>3</td><td>PARTIA A</td><td>EMËR MBIEMËR</td><td>ZK</td><td>3</td></tr> <tr><td>4</td><td>KOALICIONI A</td><td>ZK</td><td>ZK</td><td>4</td></tr> <tr><td>5</td><td>PARTIA B</td><td>EMËR MBIEMËR</td><td>ZK</td><td>5</td></tr> <tr><td>6</td><td>PARTIA E</td><td>EMËR MBIEMËR</td><td>ZK</td><td>6</td></tr> <tr><td>7</td><td>PARTIA F</td><td>EMËR MBIEMËR</td><td>ZK</td><td>7</td></tr> <tr><td>8</td><td>PARTIA G</td><td>EMËR MBIEMËR</td><td>ZK</td><td>8</td></tr> <tr><td>9</td><td>PARTIA GJ</td><td>EMËR MBIEMËR</td><td>ZK</td><td>9</td></tr> <tr><td>10</td><td>PARTIA H</td><td>EMËR MBIEMËR</td><td>ZK</td><td>10</td></tr> <tr><td>11</td><td>PARTIA I</td><td>EMËR MBIEMËR</td><td>ZK</td><td>11</td></tr> <tr><td>12</td><td>PARTIA J</td><td>EMËR MBIEMËR</td><td>ZK</td><td>12</td></tr> <tr><td>13</td><td>PARTIA K</td><td>EMËR MBIEMËR</td><td>ZK</td><td>13</td></tr> <tr><td>14</td><td>PARTIA L</td><td>EMËR MBIEMËR</td><td>ZK</td><td>14</td></tr> <tr><td>15</td><td>PARTIA LL</td><td>EMËR MBIEMËR</td><td>ZK</td><td>15</td></tr> <tr><td>16</td><td>PARTIA M</td><td>EMËR MBIEMËR</td><td>ZK</td><td>16</td></tr> <tr><td>17</td><td>PARTIA N</td><td>EMËR MBIEMËR</td><td>ZK</td><td>17</td></tr> <tr><td>18</td><td>PARTIA NJ</td><td>EMËR MBIEMËR</td><td>ZK</td><td>18</td></tr> <tr><td>19</td><td>PARTIA O</td><td>EMËR MBIEMËR</td><td>ZK</td><td>19</td></tr> <tr><td>20</td><td>PARTIA P</td><td>EMËR MBIEMËR</td><td>ZK</td><td>20</td></tr> <tr><td>21</td><td>PARTIA Q</td><td>EMËR MBIEMËR</td><td>ZK</td><td>21</td></tr> <tr><td>22</td><td>PARTIA R</td><td>EMËR MBIEMËR</td><td>ZK</td><td>22</td></tr> <tr><td>23</td><td>PARTIA RR</td><td>EMËR MBIEMËR</td><td>ZK</td><td>23</td></tr> <tr><td>24</td><td>PARTIA S</td><td>EMËR MBIEMËR</td><td>ZK</td><td>24</td></tr> <tr><td>25</td><td>PARTIA SH</td><td>EMËR MBIEMËR</td><td>ZK</td><td>25</td></tr> <tr><td>26</td><td>PARTIA T</td><td>EMËR MBIEMËR</td><td>ZK</td><td>26</td></tr> <tr><td>27</td><td>PARTIA TH</td><td>EMËR MBIEMËR</td><td>ZK</td><td>27</td></tr> <tr><td>28</td><td>PARTIA U</td><td>EMËR MBIEMËR</td><td>ZK</td><td>28</td></tr> <tr><td>29</td><td>PARTIA V</td><td>EMËR MBIEMËR</td><td>ZK</td><td>29</td></tr> <tr><td>30</td><td>PARTIA Y</td><td>EMËR MBIEMËR</td><td>ZK</td><td>30</td></tr> <tr><td>31</td><td>EMËR ATËSIA MBIEMËR</td><td>KANDIDAT I PROPOZUAR NGA ZGJEDHËSIT</td><td></td><td>31</td></tr> <tr><td>32</td><td>EMËR ATËSIA MBIEMËR</td><td>KANDIDAT I PROPOZUAR NGA ZGJEDHËSIT</td><td></td><td>32</td></tr> <tr><td>33</td><td>EMËR ATËSIA MBIEMËR</td><td>KANDIDAT I PROPOZUAR NGA ZGJEDHËSIT</td><td></td><td>33</td></tr> </tbody> </table>	1	PARTIA E BASHKIMIT TË MOTORISTËVE	EMËR MBIEMËR	P B M	1	2	PARTIA E QËNDRUESHME	EMËR MBIEMËR	P Q	2	3	PARTIA A	EMËR MBIEMËR	ZK	3	4	KOALICIONI A	ZK	ZK	4	5	PARTIA B	EMËR MBIEMËR	ZK	5	6	PARTIA E	EMËR MBIEMËR	ZK	6	7	PARTIA F	EMËR MBIEMËR	ZK	7	8	PARTIA G	EMËR MBIEMËR	ZK	8	9	PARTIA GJ	EMËR MBIEMËR	ZK	9	10	PARTIA H	EMËR MBIEMËR	ZK	10	11	PARTIA I	EMËR MBIEMËR	ZK	11	12	PARTIA J	EMËR MBIEMËR	ZK	12	13	PARTIA K	EMËR MBIEMËR	ZK	13	14	PARTIA L	EMËR MBIEMËR	ZK	14	15	PARTIA LL	EMËR MBIEMËR	ZK	15	16	PARTIA M	EMËR MBIEMËR	ZK	16	17	PARTIA N	EMËR MBIEMËR	ZK	17	18	PARTIA NJ	EMËR MBIEMËR	ZK	18	19	PARTIA O	EMËR MBIEMËR	ZK	19	20	PARTIA P	EMËR MBIEMËR	ZK	20	21	PARTIA Q	EMËR MBIEMËR	ZK	21	22	PARTIA R	EMËR MBIEMËR	ZK	22	23	PARTIA RR	EMËR MBIEMËR	ZK	23	24	PARTIA S	EMËR MBIEMËR	ZK	24	25	PARTIA SH	EMËR MBIEMËR	ZK	25	26	PARTIA T	EMËR MBIEMËR	ZK	26	27	PARTIA TH	EMËR MBIEMËR	ZK	27	28	PARTIA U	EMËR MBIEMËR	ZK	28	29	PARTIA V	EMËR MBIEMËR	ZK	29	30	PARTIA Y	EMËR MBIEMËR	ZK	30	31	EMËR ATËSIA MBIEMËR	KANDIDAT I PROPOZUAR NGA ZGJEDHËSIT		31	32	EMËR ATËSIA MBIEMËR	KANDIDAT I PROPOZUAR NGA ZGJEDHËSIT		32	33	EMËR ATËSIA MBIEMËR	KANDIDAT I PROPOZUAR NGA ZGJEDHËSIT		33
1	PARTIA E BASHKIMIT TË MOTORISTËVE	EMËR MBIEMËR	P B M	1																																																																																																																																																																			
2	PARTIA E QËNDRUESHME	EMËR MBIEMËR	P Q	2																																																																																																																																																																			
3	PARTIA A	EMËR MBIEMËR	ZK	3																																																																																																																																																																			
4	KOALICIONI A	ZK	ZK	4																																																																																																																																																																			
5	PARTIA B	EMËR MBIEMËR	ZK	5																																																																																																																																																																			
6	PARTIA E	EMËR MBIEMËR	ZK	6																																																																																																																																																																			
7	PARTIA F	EMËR MBIEMËR	ZK	7																																																																																																																																																																			
8	PARTIA G	EMËR MBIEMËR	ZK	8																																																																																																																																																																			
9	PARTIA GJ	EMËR MBIEMËR	ZK	9																																																																																																																																																																			
10	PARTIA H	EMËR MBIEMËR	ZK	10																																																																																																																																																																			
11	PARTIA I	EMËR MBIEMËR	ZK	11																																																																																																																																																																			
12	PARTIA J	EMËR MBIEMËR	ZK	12																																																																																																																																																																			
13	PARTIA K	EMËR MBIEMËR	ZK	13																																																																																																																																																																			
14	PARTIA L	EMËR MBIEMËR	ZK	14																																																																																																																																																																			
15	PARTIA LL	EMËR MBIEMËR	ZK	15																																																																																																																																																																			
16	PARTIA M	EMËR MBIEMËR	ZK	16																																																																																																																																																																			
17	PARTIA N	EMËR MBIEMËR	ZK	17																																																																																																																																																																			
18	PARTIA NJ	EMËR MBIEMËR	ZK	18																																																																																																																																																																			
19	PARTIA O	EMËR MBIEMËR	ZK	19																																																																																																																																																																			
20	PARTIA P	EMËR MBIEMËR	ZK	20																																																																																																																																																																			
21	PARTIA Q	EMËR MBIEMËR	ZK	21																																																																																																																																																																			
22	PARTIA R	EMËR MBIEMËR	ZK	22																																																																																																																																																																			
23	PARTIA RR	EMËR MBIEMËR	ZK	23																																																																																																																																																																			
24	PARTIA S	EMËR MBIEMËR	ZK	24																																																																																																																																																																			
25	PARTIA SH	EMËR MBIEMËR	ZK	25																																																																																																																																																																			
26	PARTIA T	EMËR MBIEMËR	ZK	26																																																																																																																																																																			
27	PARTIA TH	EMËR MBIEMËR	ZK	27																																																																																																																																																																			
28	PARTIA U	EMËR MBIEMËR	ZK	28																																																																																																																																																																			
29	PARTIA V	EMËR MBIEMËR	ZK	29																																																																																																																																																																			
30	PARTIA Y	EMËR MBIEMËR	ZK	30																																																																																																																																																																			
31	EMËR ATËSIA MBIEMËR	KANDIDAT I PROPOZUAR NGA ZGJEDHËSIT		31																																																																																																																																																																			
32	EMËR ATËSIA MBIEMËR	KANDIDAT I PROPOZUAR NGA ZGJEDHËSIT		32																																																																																																																																																																			
33	EMËR ATËSIA MBIEMËR	KANDIDAT I PROPOZUAR NGA ZGJEDHËSIT		33																																																																																																																																																																			

Data: 11.12.2024

Nr: 209

Ora: 15:00



“Për miratimin e raportit mbi gjetjet pas vlerësimit të regjistrimeve filmike gjatë implementimit të votimit elektronik në bashkitë Kamëz, Vorë dhe Elbasan, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”

REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
KOMISIONI QENDOR I ZGJEDHJEVE  
**FLETË VOTIMI**  
ZGJEDHJET PËR KRYETARIN E BASHKISË, 6 MARS 2022  
Qarku Tiranë Bashkia Vorë  
Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore  
ZAZ Nr. 26 QV Nr. 1547.00\_01  
QV: 1551.1\_01

**Zgjidh kandidatin**

1	Kandidati 1 Partia/Koalicioni 1	<input type="checkbox"/>
2	Kandidati 2 Partia/Koalicioni 2	<input type="checkbox"/>
3	Kandidati 3 Partia/Koalicioni 3	<input type="checkbox"/>
Nuk zgjedh asnjë kandidat		

Printo votën >

**FLETË VOTIMI**  
Qarku Tiranë Bashkia Vorë  
Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore DEMONSTRIM

**Zgjidh kandidatin për KRYETAR BASHKIE**

1		<b>LIONEL MESSI</b> ARGENTINA AFA, COMMEBOL	ARG	<input checked="" type="checkbox"/>
2		<b>ANTOINE GRIEZMANN</b> FRANCE FFF, UEFA	FRA	<input type="checkbox"/>
3		<b>ACHRAF HAKIMI</b> MOROCCO FFM, CAF	MAR	<input type="checkbox"/>
4		<b>KYLIAN MBAPPE</b> FRANCE FFF, UEFA	FRA	<input type="checkbox"/>
5		<b>JUDE BELLINGHAM</b> ENGLAND FA, UEFA	ENG	<input type="checkbox"/>
NUK ZGJEDH ASNJË KANDIDAT				

Konfirmo votën >

**FLETË VOTIMI**  
Qarku Tiranë Bashkia Vorë  
Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore DEMONSTRIM

**Zgjidh subjektin për KËSHILLIN BASHKIAK**

1	ARGENTINA	LIONEL MESSI	ARG	<input checked="" type="checkbox"/>
2	FRANCE	KYLIAN MBAPPE	FRA	<input type="checkbox"/>
3	CROATIA	LUKA MODRIĆ	CRO	<input type="checkbox"/>
4	MOROCCO	ROMAIN SAÏS	MAR	<input type="checkbox"/>
5	NETHERLANDS	VIRGIL VAN DIJK	NED	<input type="checkbox"/>
6	ENGLAND	HARRY KANE	ENG	<input type="checkbox"/>
7	BRAZIL	THAIGO SILVA	BRA	<input type="checkbox"/>
8	PORTUGAL	CRISTIANO RONALDO	POR	<input type="checkbox"/>
9	JAPAN	AKA YOSHIDA	JPN	<input type="checkbox"/>
10	SENEGAL	KALIDOU KOULIBALY	SEN	<input type="checkbox"/>
11	AUSTRALIA	MATHEW RYAN	AUS	<input type="checkbox"/>
12	SWITZERLAND	GRANT SHAKA	SUI	<input type="checkbox"/>
13	SPAIN	ALVARO MORATA	ESP	<input type="checkbox"/>
14	USA	TYLER ADAMS	USA	<input type="checkbox"/>
15	POLAND	ROBERT LEWANDOWSKI	POL	<input type="checkbox"/>
NUK ZGJEDH ASNJË SUBJEKT				

Printo votën >

**FLETË VOTIMI**  
Qarku Tiranë Bashkia Vorë  
Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore DEMONSTRIM

**Zgjidh kandidatin për KRYETAR BASHKIE**

1		<b>LIONEL MESSI</b> ARGENTINA AFA, COMMEBOL	ARG	<input checked="" type="checkbox"/>
2		<b>ANTOINE GRIEZMANN</b> FRANCE FFF, UEFA	FRA	<input type="checkbox"/>
3		<b>ACHRAF HAKIMI</b> MOROCCO FFM, CAF	MAR	<input type="checkbox"/>
4		<b>KYLIAN MBAPPE</b> FRANCE FFF, UEFA	FRA	<input type="checkbox"/>
5		<b>JUDE BELLINGHAM</b> ENGLAND FA, UEFA	ENG	<input type="checkbox"/>
NUK ZGJEDH ASNJË KANDIDAT				

Konfirmo votën >

**FLETË VOTIMI**  
Qarku Tiranë Bashkia Vorë  
Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore DEMONSTRIM

**Zgjidh subjektin për KËSHILLIN BASHKIAK**

1	ARGENTINA	LIONEL MESSI	ARG	<input checked="" type="checkbox"/>
2	FRANCE	KYLIAN MBAPPE	FRA	<input type="checkbox"/>
3	CROATIA	LUKA MODRIĆ	CRO	<input type="checkbox"/>
4	MOROCCO	ROMAIN SAÏS	MAR	<input type="checkbox"/>
5	NETHERLANDS	VIRGIL VAN DIJK	NED	<input type="checkbox"/>
6	ENGLAND	HARRY KANE	ENG	<input type="checkbox"/>
7	BRAZIL	THAIGO SILVA	BRA	<input type="checkbox"/>
8	PORTUGAL	CRISTIANO RONALDO	POR	<input type="checkbox"/>
9	JAPAN	AKA YOSHIDA	JPN	<input type="checkbox"/>
10	SENEGAL	KALIDOU KOULIBALY	SEN	<input type="checkbox"/>
11	AUSTRALIA	MATHEW RYAN	AUS	<input type="checkbox"/>
12	SWITZERLAND	GRANT SHAKA	SUI	<input type="checkbox"/>
13	SPAIN	ALVARO MORATA	ESP	<input type="checkbox"/>
14	USA	TYLER ADAMS	USA	<input type="checkbox"/>
15	POLAND	ROBERT LEWANDOWSKI	POL	<input type="checkbox"/>
NUK ZGJEDH ASNJË SUBJEKT				

Printo votën >

**Konfirmo ose ndrysho votën tuaj**

Ju keni zgjedhur

**1. LIONEL MESSI**  
ARGENTINA  
AFA, COMMEBOL


**Konfirmo ose ndrysho votën tuaj, e cila është shfaqur edhe në ekranin e printerit**

Ju keni zgjedhur

**1. ARGENTINA**



Raporteve të gjeneruara gjatë votimit përfshijnë raportin e hapjes, konfirmimin e fletës së votimit (VVPAT), raportin e mbylljes si dhe rezultatin të realizuara për zgjedhjet vendore të 14 majit 2023 .

Raporti i hapjes së QV	VVPAT	Raporti i Mbylljes së QV	Raporti i rezultatit												
<p><b>RAPORTI I HAPJES SE QENDRES SE VOTIMIT</b> 14/05/2023 23:23:52</p> <p>Zgjedhjet për: KRYETAR BASHKIE Data e zgjedhjeve: 12/04/2023 14:00:00 ZAZ Nr.: 26 Qendra e votimit: 1547.00_01</p> <p>Lloji i pajisjes: EVM Gjendja e pajisjes: ISAPUR Numri i zgjedhësve të regjistruar: 1002 Numri i pjesëmarrësve në votim: 0 Vota të pavlefshme: 0</p> <p>Kryetari</p> <p>Emër Mbiemër Fëmë</p> <p>Sekretari</p> <p>Emër Mbiemër Fëmë</p> <p>Anëtar 1</p> <p>Emër Mbiemër Fëmë</p> <p>Anëtar 2</p> <p>Emër Mbiemër Fëmë</p> <p>Anëtar 3</p> <p>Emër Mbiemër Fëmë</p> <p>Anëtar 4</p> <p>Emër Mbiemër Fëmë</p> <p>Anëtar 5</p> <p>Emër Mbiemër Fëmë</p> <p>Versioni i aplikacionit: 1.18.0.14623 Versioni i OS: 4.0.0.14623-qa</p> <p>FUNDI I DOKUMENTIT</p>	<p><b>Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore</b> ZAZ Nr.: 26 Qendra e votimit: 1547.00_01</p> <div style="border: 1px solid black; padding: 5px; text-align: center;"> <p>KRYETAR BASHKIE</p> <p><b>1. LIONEL MESSI</b> ARGENTINA</p> </div>	<p><b>RAPORTI I MBYLLESE SE QENDRES SE VOTIMIT</b> 14/05/2023 23:58:30</p> <p>Zgjedhjet për: KRYETAR BASHKIE Data e zgjedhjeve: 12/04/2023 14:00:00 ZAZ Nr.: 26 Qendra e votimit: 1547.00_01</p> <p>Lloji i pajisjes: EVM Gjendja e pajisjes: MBYLLUR Numri i zgjedhësve të regjistruar: 1002 Numri i pjesëmarrësve në votim: 2</p> <p>Kryetari</p> <p>Emër Mbiemër Fëmë</p> <p>Sekretari</p> <p>Emër Mbiemër Fëmë</p> <p>Anëtar 1</p> <p>Emër Mbiemër Fëmë</p> <p>Anëtar 2</p> <p>Emër Mbiemër Fëmë</p> <p>Anëtar 3</p> <p>Emër Mbiemër Fëmë</p> <p>Anëtar 4</p> <p>Emër Mbiemër Fëmë</p> <p>Anëtar 5</p> <p>Emër Mbiemër Fëmë</p> <p>Versioni i aplikacionit: 1.18.0.14623 Versioni i OS: 4.0.0.14623-qa</p> <p>FUNDI I DOKUMENTIT</p>	<p><b>RAPORTI I MBYLLESE SE QENDRES SE VOTIMIT</b> 15/05/2023 16:13:33</p> <p>Zgjedhjet për: KRYETAR BASHKIE Data e zgjedhjeve: 12/04/2023 14:00:00 ZAZ Nr.: 26 Qendra e votimit: 1547.00_01</p> <p>Lloji i pajisjes: EVM Gjendja e pajisjes: MBYLLUR Numri i zgjedhësve të regjistruar: 1002 Numri i pjesëmarrësve në votim: 2 Vota të pavlefshme: 0</p> <p>1547.00_01</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Kandidatët</th> <th>Vota</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1. LIONEL MESSI ARGENTINA (ARG)</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>2. ANI OINE GRIEZMANN FRANCE (FRA)</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>3. ACHRAF HAKIMI MOROCCO (MAR)</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>4. KYLIAN MBAPPÉ FRANCE (FRA)</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>5. JUDE BELLINGHAM ENGLAND (ENG)</td> <td>0</td> </tr> </tbody> </table>  <p>Versioni i aplikacionit: 1.18.0.14623 Versioni i OS: 4.0.0.14623-qa</p> <p>FUNDI I DOKUMENTIT</p> <p>*Forme e ngjashme edhe për rezultatin për këshill</p>	Kandidatët	Vota	1. LIONEL MESSI ARGENTINA (ARG)	2	2. ANI OINE GRIEZMANN FRANCE (FRA)	0	3. ACHRAF HAKIMI MOROCCO (MAR)	0	4. KYLIAN MBAPPÉ FRANCE (FRA)	0	5. JUDE BELLINGHAM ENGLAND (ENG)	0
Kandidatët	Vota														
1. LIONEL MESSI ARGENTINA (ARG)	2														
2. ANI OINE GRIEZMANN FRANCE (FRA)	0														
3. ACHRAF HAKIMI MOROCCO (MAR)	0														
4. KYLIAN MBAPPÉ FRANCE (FRA)	0														
5. JUDE BELLINGHAM ENGLAND (ENG)	0														





Aneks 3

Lista e KQV-ve, ku janë evidentuar shkelje nga operatorët PEVN, gjatë zgjedhjeve vendore të 14 maj 2023.

**BASHKIA VORË**

Nr	Bashkia Vorë	ZAZ	QV	Operatori PEVN
1	Bashkia Vorë	ZAZ 26	1546/00	O.D
2	Bashkia Vorë	ZAZ 26	1549/00	A.C
3	Bashkia Vorë	ZAZ 26	1563/00	M.K

**BASHKIA ELBASAN**

Nr	Bashkia Elbasan	ZAZ	QV	Operatori PEVN
1	Elbasan	ZAZ 47	2449/00	V.F
2	Elbasan	ZAZ 50	2343/00	M.B
3	Elbasan	ZAZ 47	2379/00	R.Z
4	Elbasan	ZAZ 47	2381/00	L.K
5	Elbasan	ZAZ 47	2383/00	B.B
6	Elbasan	ZAZ 47	2383/01	F.M
7	Elbasan	ZAZ 47	2390/00	XH.R
8	Elbasan	ZAZ 47	2407/00	E.S
9	Elbasan	ZAZ 47	2421/00	J.S
10	Elbasan	ZAZ 47	2433/00	V.A
11	Elbasan	ZAZ 47	2481/01	A.P
12	Elbasan	ZAZ 47	2432/00	D.D

**BASHKIA KAMËZ**

Nr	Bashkia Kamez	ZAZ	QV	Operatori PEVN
1	Tirane	ZAZ 27	1589/00	A.V
2	Tirane	ZAZ 27	1600/00	E.A

